VENDIM
Nr.307, datë 16.4.2004

PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2004

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë të nenit 87 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve për vitin 2004, në shumën 242 000 000 (dyqind e dyzet e dy milionë) lekë, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJE 1
STRUKTURA E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2004

Nr.	Emërtimi	Milionë lekë
	Shpenzime gjithsej:	242
1	Fond page dhe sigurime shoqërore	37
2	Shërbime	23
2.1	Kualifikimi i stafit	5
2.2	Shërbime bazë	6
2.3	Shërbime social-kulturore	3.5
2.4	Udhëtim e dieta	6.5
2.5	Shërbime të tjera	2
3	Investime	182
3.1	Ngritja e qendrës së monitorimit dhe e kontrollit të frekuencave	100
3.2	Asistencë e huaj për hartimin e metodologjisë së kontrollit të tarifave të operatorëve celularë	10
3.3	Asistencë e huaj për hartimin e kuadrit rregullator për licencimin e operatorëve në zonat urbane dhe ndërurbane	9.5
3.4	Studimi i tregut dhe i shfrytëzimit të brezave wireless	11.5
3.5	Projektimi i qendrës së monitorimit	6.2
3.6	Informatizimi i ERT-së	10
3.7	Ndërtim godine shtesë	20
3.8	Blerje pajisje zyrash	5.7
3.9	Blerje motor gjenerator, automjete, kondicionerë etj.	9.1